



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA*

**C.nr.174/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, departamenti i përgjithshëm, i përbërë nga gjyqtari individual Ragip Kadriu, në çështjen juridike të paditësit-kundërpaditurit: SHK nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av.NM nga ..., kundër të paditurit-kundërpaditësit: RS nga Fsh ..., Komuna e ... te cilin me autorizim e përfaqëson FB Avokate ne ... dhe AS, BS dhe MS qe te tre nga Fsh. ...- Komuna e ... sipas autorizimit me shkrim , dhe te paditurit GD nga ... tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson Perfaqesuesi i perkohshem AL Avokat ne ... sipas aktvendimit te kesaje gjykate, baza e kontestit: Lirimi i Pronës dhe anulim i kontrates pas mbajtjes së seancës kryesore, te dt. 13.05.2019 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit-Kundërpadituri: SHK nga Mitrovica, kundër të paditurit-kundërpaditësit të parë RS me të cilën kërkoi lirim të paluajtshmeris-ngastren kadastrale numër Nr...., sipas fletës poseduese Nr...., në vendin e quajtur .../... me sipërfaqe prej ....m2, ....- Komuna e ....
  
- II. **HUDHET SI E PARREGULLT**-kundërpadia e të paditurit te pare-kundërpaditësit RS kundër paditësit SHK nga Mitrovica me te cilin kerkoi qe te **Vertetohet** se kontrata e lidhur ndermjet Agjencionit Tatimor te Kosoves dhe SHD qe ka te beje me shitjen e pasurise se ... ,, ... te palujtshmerise – ngastres katastrale nr.... te evidentuar ne fl.pos.nr... ZK ... me kulture ndertese ne siperfaqe prej ... ha dhe oborr ne siperfaqe prej ... , ne vendin e quajtur ,, ... / ...,, ne shume prej 153,000,99 Euro , eshte lidhur ne kundershtim me dispozitat e Rregulloreve te UNIMI-ut 2002/12, 2003/13 – Vendimi i Dhomes se Posaqme te Gjykates Supreme te Kosoves per motarium te pasurise se ,, Trepces ,, dhe si e tille kjo kontrate nuk prodhon efekt juridik dhe nuk ka vlere juridike.

**III. APROVOHET** kerkespadia e te paditurit- Kundrpaditesit RS , kunder paditesit- Kundrpaditurit SHK dhe **Vertetohet** se kontrata e lidhur ndermjet SHD dhe SHK per faljen e palujtshmerise Vr. Nr. .... dt .... eshte **NULE**, andaj kontrata si e tille nuk prodhon efekt juridik.

-Detyrohet paditesi qe Perfaqsuesit te perkohshem Av. AL nga ... ti kompenzoj shpenzimet per perfaqsim ne shume prej 422,00 Euro, ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Paditësi, ka parashtruar padi kundër të paditurve RS dhe GD, duke theksuar se është pronar i paluajtshmeris e cila gjendet në ... dhe evidentohet sipas fletës poseduese nr...., pronë e cila është e uzurpuar nga të paditurit të cilët refuzojn që pronari ta shfrytzoj këtë pronë.

I autorizuari i paditësit-kundërpadituri Av.NM, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se qëndron pranë padisë dhe kërkespadisë me datë 22.06.2016 është bërë precizimi i padisë së parashtruar për lirim të paluajtshmeris nga sendet dhe njerëzit në atë kohë që nuk qëndron fakti që e ka bërë një precizim të padisë. Ndërsa sa i përket hetimit bazuar në vepër penale kjo gjë e till nuk ka rezultuar me ndonjë element inkriminues në raport me ushtruesit e kallzimit penal për faktin se prona që është blerë në atë periudhë kohore është blerë me të gjitha procedurat të rregullta ligjore konform ligjeve të Kosovës. Më tutuje deklaroi prona e cila është kontestuese është blerë në Ankandë Publik nga SHD me Aktvendimin Nr.... me datë ..., duke pretenduar se në këtë mënyrë e fiton të drejtën në paluajtshmeri. Moteli sipas fletës poseduese në sipërfaqe prej .. ari e ...m, së bashku më oborr në sipërfaqe ... ari e ...m, pronë .... në .... Paditësi SHK dhe blerësi me ankand publik SHD, kanë raporte familjare e të njëjtit kanë bërë Kontratë për Faljen e Paluajtshmeris të cilën SHD e ka fituar përmes Ankandit Publik dhe në këtë mënyrë bazuar në nenin 536 të LMD-së, një gjë e till është e lejuar pasi që një person mund të bartë te tjetëri ndonjë send si objekt dhurate me anë të Kontratës për dhuratën. Kjo paluajtshmeri përveq me Kontratë për të është bërë edhe regjistrimi ne regjistrat kadastral, duke i plotësuar që të dy kushtet në mënyrë kumulative.

Sa i përket palës së kundërt, pa të drejtë është vendosur në pronë dhe prej kohësh është duke e shfrytëzuar pa leje të pronarit ligjor të pronës, duke pretenduar se kjo pronë është e paraardhësit të tyre SHS, e vërtetuar në Gjykatën e rrethit të Mitrovicës 20.02.1941. Me Aktvendimit e Këshillit Popullor të Komunës së Mitrovicës, kjo tokë është Eksproprijuar nga ana e Shtetit, ashtu që asnjë provë në drejtim që nuk është eksproprijuar nga ana e shtetit nuk është ofruar. Në ekspertizën e ekspertit të Gjeodezis, konstatohet që ngastra kontestuese me kulturë

ndërtesë është evidentuar në emer të paditësit- kundërpaditësit SHK. Duke pasur parasysh faktin se paditësi, është pronar i paluajtshmeris e cila evidentohet në Certifikatën e Zyres Kadastrale të Mitrovicës me nr. .... për zonën kadastrale ...., me numër të njesisë P-..... në sipërfaqe të tërsishme prej ... metra 2 në vendin e quajtur .... Këtë tokë e paditura pa të drejtë e ka rrethuar, duke uzurpuar dhe shfrytëzuar pa ndonjë të drejt nga ana e pronarit. Paditësi pretendon që në pamundësi për të shfrytëzuar pronën e tij ka pasur dëme të konsiderushme materiale. Andaj nga të lartëcekuart i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të e aprovoj padinë e paditësit si të bazuar.

Ndrsa sa i perket kundërpadise se te paditurit-kunderpaditesit e refuzon ne tersi si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoi.

I padituri RS ka parashtruar kundërpadi ndaj paditesit duke theksuar se me vendimin e Keshillit Popullor te Komunes se Mitrovices te dt. ... , per shkak te interesit te pergjitheshem dhe me qellim te ndertimit te motelit behet ekspropriimi i tokes i cili eshte objekt i ketij kontesti . Kunder ketij aktvendimi nuk lejohet ankesa , mirrepo kompenzim per kete palujtshmeri nuk ka marr as paraardhesi e as tani pasardhesit e kesaj palujtshmerie .

Administrata Tatimore e Kosoves per shkak kinse borgjit tatimor ka aplikuar masen e konfiskimit dhe shitjes se palujtshmerise tani lendore qka ky vendim i ATK-es , eshte nje kundërshtim me dispozitat e Rregulloher se UNMIK-ut 2002/12 dhe te vendimit te Deges se Posaqshme te Gjykates Supreme te Kosoves per motariumin mbi pasurin e ,, ....., te dt. ....

Me vendim per motarium theksohet se vetem ne vendimin e Dhomes se Posaqme te Gjykates se Kosoves mund te ndermiren veprimet e shitjes se palujtshmerise se Ndermarrjeve Shoqerore.

Me qenese kemi shkelje te drejteperdrejte te dispozitave ligjore te vlefshme ne kohen e lidhjes se kontrates – Certifikates per shitje te ATK-es, konsiderojme se e njejta nuk sjelle pasoja juridike ne pronesine kontestuese. Njekohesisht bleresi SHD ne kontrate mbi faljen ia barte dhuratmarresit palujtshmerine kontestuese gje qe paraqet ndryshim te larte te bazuar se kemi te bejme me pastrimin e parave pasi qe shuma e blerjes se palujtshmerise kinse nga ATK-eja ishte 153,000,99 Euro , kush mund te fale kete shume kur keta persona nuk jane familjar ne mes veti , prandaj i padituri i pare – kunderpaditesi ka interes juridik per mosekzistimin e ketij raporti juridik , prandaj i propozon gjykates qe te refuzohet kerkesepadia e paditesit ndersa te aprovohet kerkesepadia e te paditurit – kunderpaditesit.

E autorizuar - e të paditurit të parë dhe kundërpaditurit në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: mbeten në tërsi pranë kundërpadisë edhe më tutje e kundërshtojnë në tërsi padinë dhe kërkesën e paditësit, pasi që është e pazuar dhe mbesin në tërsi pranë kundërshtimeve dhe propozimeve si në seancat e mbajtura duke shtuar edhe njëherë se palujatshmeria kontestuese është pronë e paraardhësve të të paditurve kundërpaditësve të cilët të njëjtën pronë e kanë blerë sipas kontratës mbi shitëblerje e vërtetuar në Gjykatën e rrethit në Mitrovicë me datë 20.02.1941, këtë palujatshmeri paraardhësit e të paditurit-kundërpaditësit, Me tutje deklaroi se familja ... e ka shfrytëzuar pa ndërprerë deri në vitin 1960 kur është marrë për nevojat e ndërtimit të një hoteli mirëpo asnjë kompenzim nuk ka marrë as paraardhësit e tani të paditurit RS e as i padituri respektivisht familja ... Ky Hotel është rrënuar dhe kjo palujatshmeri është liruuar dhe këtë palujatshmeri e ka marrë në procedim që janë pronar tani familja ... dhe e kanë në shfrytëzim të lirë. Me tutje e autorizuar deklaroi se bazuar në aktin më të lartë juridik kushtetutes saktësisht neni 46 par.3 i po të njëjtit, neni 17 i Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut, i jep të drejtë qdokujt të ketë pasuri, vetëm apo në bashkësi me të tjerët dhe askush nuk bën që në mënyrë arbitrare të provohet nga pasuria e vet, dhe kjo i jep të drejtën që qdokush të gëzojë me pronën e tij/saj, duke e përjashtuar të drejtën e kujdoqoft, që tjetërit në mënyrë arbitrare t'ia marrë pasurinë. Moteli është evidentuar në certifikatën e pronësore si Pasuri Shoqërore, Ndërmarrja ... me numër të fletës poseduese ..., ngastra kadastrale ..., ZK ...c, në vendin e quajtur ... me kulturë shtëpi/ndërtes me sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup> dhe oborr me sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup>, gjithsejt me sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup>, e sipas ankandit të PTK-së ishte pronë e ... edhe pse nuk figuron emri i saj, po ashtu deklaroi se egziston edhe shpallja në gazetë të njoftimit për shitje me oferta të mbylluar me datë ... nga ana e ATK-s. Po ashtu deklaroi se Njoftimi i Zyres regjionale nq ... ATK i datës ... në emër të tatim paguesit ... me numër të regjistrimit të biznesit ..., me pronar OH me adresë ... në ..., prove kjo e cila kombinati ... bazohet në një pronar. Sipas Certifikatës së shitjes ... i datës ... në emër të tatim paguesit ... kishte borxh obligime tatimore dhe ATK-ja, ka aplikuar masën e konfiskimit dhe shitjen e pasurisë së palujatshme ashtu që si ofertues paraqiten 10 persona ku i treti ishte SHK ndërsa i dhjeti SHD. Ashtu që blerësi i pronës dhe pasurisë shoqërore SHD, sipas certifikatës ... me datë ... ka paguar 153.000.99 euro për blerjen e pasurisë ... Motelit. Nga faturat në bankën ... shihen qartë pagesat e shitëblerjes së Motelit, që të gjitha janë kryer nga SHK e jo nga SHD edhe pse SHK kishte konkuruar në këtë ankand duke dhënë qmimin më të lirë. Ashtu që bazuar mbi faljen e palujatshmeris në bazë të kontratës ndërmjet pronarit SHD si dhuratëdhënës dhe SHK si dhuratëmarrës bëhet bartja e pronësisë, kontratë e cila sipas saj është fiktive. Ashtu siq thkesohet edhe në Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë më satësisht në faqen e dytë të Aktvendimit, se kemi kurdisje të tenderit, por për shkak të parashkrimit është hudhë poshtë kallëzimi penal. Andaj bazuar në pretendimet e dhëna e njëjta propozon që të aprovohet kundërpadia të aprovohet në tërsi si e bazuar, pasi që me provat e administruara u vërtetua një gjë e tillë.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të dytë në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se sa i përket faktit se këtë paluajtshmeri e ka blerë SHD i paraqet dy faktura të Bankes ... ku vërtetohet se paditësi SHK ka bërë pagesën për blerjen e pronës së kontestuar e jo SHD, andaj edhe kontrata mbi faljen e paluajtshmeris lidhur me datë ..., ndërmjet SHD dhe SHK është vetëm fiktive pasi që vërtetohet me këto faktura. Duke pretenduar se e tërë procedura e blerës së paluajtshmeris është e bazuar në vepër penale por, për shkak të parashkrimit është ardh edhe tek hudhja posht e kallazimit penal e jo edhe për mbrojtjen e të drejtave pronësore të të paditurit të dytë të cilin e përfaqëson. Më tutje përfaqësuesi i të paditurit të dytë deklaroi se bazuar në aktin më të lartë juridik kushtetuten saktësisht neni 46 par.3 i po të njëjtit, neni 17 i Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut, i jep të drjetë qdokujt të ketë pasuri, vetëm apo në bashkësi me të tjerët dhe askush nuk bën që në mënyrë arbitrare të provohet nga pasuria e vet, dhe kjo i jep të drejtën që qdokush të gëzoj me pronën e tij/saj, duke e përjashtura të drejtën e kujdoqoft, që tjetërit në mënyrë arbitrare t'ia marrë pasurinë. Moteli është evidentuar në certifikatën e pronësore si Pasuri Shoqërore, Ndërmarrja ... me numër të fletës poseduese ..., ngastra kadastrale ..., ZK ..., në vendin e quajtur ... me kultur ... me sipërfaqe prej ... m2 dhe oborr me sipërfaqe prej ... m2, gjithsejt me sipërfaqe prej ... m2, e sipas ankandit të PTK-së ishte pronë e ... edhe pse nuk figuron emri i saj, po ashtu deklaroi se egziston edhe shpallja në gazetë të njoftimit për shitje me oferta të mbylluar me datë ... nga ana e ATK-s. Po ashtu deklaroi se Njoftimi i Zyres regjionale nq Mitrovicë ATK i datës ... në emër të tatim paguesit ... me numër të regjistrimit të biznesit ..., me pronar OH me adresë .... në ... , prove kjo e cila ... bazohet në një pronar. Sipas Certifikatës së shitjes ... i datës ... në emër të tatim paguesit ... kishte borxh obligime tatimore dhe ATK-ja,ka aplikuar masën e konfiskimit dhe shitjen e pasurisë së paluajtshme ashtu që si ofertues paraqiten 10 persona ku i treti ishte SHK ndërsa i dhjeti SHD. Ashtu që blerësi i pronës dhe pasurisë shoqërore SHD, sipas certifikatës ... me datë .... ka paguar .... euro për blerjen e pasurisë .... Nga faturat në bankën Banka Ekonomike shihen qartë pagesat e shitëblerjes së Motelit, që të gjitha janë kryer nga SHK e jo nga SHD edhe pse SHK kishte konkuruar në këtë ankand duke dhënë qmimin më të lirë. Ashtu që bazuar mbi faljen e paluajtshmeris në bazë të kontratës ndërmjet pronarit Shaban Dërguti si dhuratëdhënës dhe SHK si dhuratëmarrës bëhet bartja e pronësis, kontratë e cila sipas saj është fiktive. Ashtu siq theksohet edhe në Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë më satësisht në faqen e dytë të Aktvendimit, se kemi kurdisje të tenderit, por për shkak të parashkrimit është hudhë poshtë kallëzimi penal. Andaj bazuar në pretendimet e dhëna e njëjti propozon që të aprovohet kundërpadia të aprovohet në tërsi si e bazuar, pasi që me provat e administruara u vërtetua një gjë e tillë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kerkoi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova materiale:

Historiku i parcelës kadastrale ... nga Drejtoria për Gjeodezi Kadaaster dhe Prone –Komuna e Mitrovicës e datës ..., Ekspertiza ... i datës ..., Kopja e Planit me Bashkim Pareclave lëshuar nga Komuna e ..., Plani para bashkimit të parcelave ..., ..., ..., ..., Të dhënat Baze për Njësi lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike –Agjencia Kadastrale e Kosovës per paluajtshmerin Nr. P-.... e datës ..., Fleta Poseduese Nr.....e datës ..., Kopja e Planit me Nr. Protokolli ..., Aktvendimi Mbi Transferin e Shitur përmes Ankadit Publik Nr..... e datës ..., Kontrata mbi Faljen e Paluajtshmeris Nr.... të datës ..., Certifikata e shitjes Nr... e datës ..., Certifikata mbi të drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr..... e datës ..., Certifikata mbi të drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr.UL-... e datës ..., Kopja e Planit Nr Prot...., Aktvendimi Nr. I lëndes Protokollit ...me datë ..., Skica me Ortofoto i datës ..., Certifikata mbi të drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr.UL-.... e datës ..., Kallzimi Penal Nr..... me datë ..., Aktvendimi PP-II.nr.... i datës ...,

Urdhërpagesat nga Banka ... të datës ..., Urdhërpagesa e Tatimit e datës ..., Vertetimi i Drejtoris për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Zjarri Nr.... i datës ..., Kërkesa për kthimin e paluajtshmeris Nr. ...e datës ...

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Faktet jo Kontestuese:

Nuk është kontestuese fakti se që nga viti 2006 në bazë të Aktvendimit nr... i datës ..., paluajtshmeria tani lendore, prone e .... transferohet permes ankandit publik ne emer te blersit të SHD. Ndërsa në vitin 2006 në bazë të Kontartës mbi Faljen Nr.... e datës ... nga SHD, kalon në emer të SHK,

Nuk është kontestuese fakti se SHD ka blerë paluajtshmerin lendore sipas Fletësposeduese ndërtes në sipërfaqe ... ari e ...m, së bashku në sipërfaqe prej .. ari e ..m, pronë kjo ... ..., në vendin e quajtur ... ngastra ... sipas skicës së ekspertit, Fleta Poseduese Nr...., Zona Kadastrale Nr..., nëpërmjet Ankandit Publik të mbajtur me datë ..., Ankand ky i organizuar përmes ATK-së, në shumë prej ... euro, ky fakt vërtetohet nga Aktvendimi mbi transferin e pronës së shitur përmes Ankandit Publik Nr.... e datës ...

Për Gjykatën nuk është kontestuese fakti se Administrata Tatimore e Kosovës, për mos pagesën e obligimeve tatimore, ka bërë shitjen e pasuris së paluajtshme të ... pronë kjo e cila ka qenë e konfiskuar dhe në mungesë të

përmbushjes së obligimit tatimor nga e njëjta, është hap procedura e shitjes, për të cilën si ofertues më i suksesshëm është shpall SHD, ky fakt nga gjykata u vërtetua duke u bazuar në Certifikatën e Shitjes Nr.... të datës ....

Nuk është kontestuese për gjykatën se kërkesa e SHD për bartjen e patundëshmeris nga paracela kadastrale Nr...., fleta poseduese nr.... ZK ...Komuna ... e njëjta është aprovuar, ky fakt u vërtetua nga Aktvendimi Nr.Prot.... i datës ...

Nuk është kontestuese fakti se SHD në bazë të Kontratës Mbi Faljen si dhuratëdhënës në njëren anë, i'a ka falur paditësit-kundërpaditurit dhurëtmarrësit paluajtshmerin e cila evidentohet në Certifikatën e Agjencionit Kadastral të Kosovës- Zyres Kadastrale Komunale në Mitrovicë Ul- ... Zona Kadastrale ... -... të datës ...., me numër të Prot...., me numër të njësisë P-..., në vendin e quajtur ... në sipërfaqe prej... m2, ky fakt u vërtetua nga Kontrata Nr.... e datës ....

Nuk është kontestuese fakti se pas kallëzimit penal të ushtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm, Prokuroria Themelore në Mitrovicë nxjerr Aktvendim PP-II.nr.... i datës ... për hudhjen poshtë të kallëzimit penal për shkak të arritjes së parashkrimit relativ të ndjekjes penale, i njëjti Aktvendim parasheh se sa i përket veprës penale keqpërdorim i autorizimeve ne ekonomi shihet se ka kurdisje të tenderit, por për arsye të parashkrimit relativ për arsye se kjo vepër penale është kryer ne datë ... e lënda ka arrit ne Prokurori ne datë ... ku kanë kaluar më shumë se 10 vite dhe e njëjta është parashkruar.

Nuk është kontestuese fakti se pagesat lidhur ne pronën ne fjalë i ka bërë paditësi-kundërpadituri dhe kjo vërtetohet në bazë të faturave lëshuar nga Banka ... të datës ....Nga provat e sipercekura rrjedhe se Administrata Tatimore e Kosovës -Zyra Regjionale në Mitrovicë,për shkak të borxhit tatimor ka aplikuar masën e konfiskimit dhe shitjen e paluajtshmeris të .... e cila është realizuar në ankandin publik. Vendim ky i cili del të jetë në kundërshtim me Rregulloret e UNMIK-ut 2002/12 dhe 2003/13 dhe vendimeve të Dhomes së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Moratoriumin mbi pasurin e ... e datës .... Sipas Rregullorve i vetmi organ që ka të drejtë të jap në privatizim me qera, më saktësisht në shfrytëzim afatëgjatë për 99 vite, ishte vetëm Agjensioni i Mirëbesimit të Kosovës, rregullore të cilat kanë qenë në fuqi bazuar në të lartëpërmnedurat, si dhe në vendimin për Moratorium theksohet se vetëm me vendimin e Dhomes së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mund të ndërmerren veprimet e shitjes së paluajtshmerive shoqërore e gjithë kjo është në kundërshtim me veprimet të cilat janë ndërmarr duke filluar nga shitja e pronës e deri tek lidhja e kontratës mbi faljen e paluajtshmeris me numër kadastral nr....., të

evidentuar në fletës poseduese Nr.... ZK ..., në vendin e quajtur ... me kultur shtëpi-ndërtes me sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup> dhe me oborr me sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup>, gjithsejt me sipërfaqe prej ...m<sup>2</sup>, e shitur në shumë prej ... euro.

Lidhur me pretendimin e paleve ndergjyqese, gjykata vlerësoi se bazuar në nenin 95 të LMD-së, është percaktuar se qdo person i interesuar mund të kërkoj nulitetin e kontratës, dhe se kjo e drejt nuk parashkruhet [ nen.96 LMD], bazuar në provat e sipercekura, rrjedh se Kontrata mbi dhurimin e palujtshmeris e sipercekur, kemi të bëjm më kontratë fiktive, respektisht me pune juridike -simulative [ me kontraten e dhurimit] e qe kto jane pune juridike nule,[ nen. 111 te LMD]. nga se blers i ksaj palujtshmerie ka qene SHD,, ndrsa pagesa eshte bere nga tani paditesi SHK,, e qe pase kesaj kan lidhur edhe kontraten mbi dhurimin.

Gjykata në rastin e vendosjes si në pikën I dhe III të dispozitivit u bazu në nenin 50 par.1 të LMD-së (cituat) **1. “Kontrata fiktive nuk ka efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese”**, po ashtu u bazua edhe në nenin 3 par.3.3 të LPK-së **“Gjykata nuk do t’i miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me: a) rendin juridik; b) dispozitat ligjore; c) rregullat e moralit publik”**. Kontratë e pavleshme llogariten të gjitha ato kontrata të cilat lidhen në kundërshtim me rendin juridik, dispozitivat imperativë si dhe të gjitha ato kontrata të cilat e cenojn interesin e përgjithshëm. Kjo e cila bën që paditësi- kundërpadituri të i refuzohet padia si e pa bazuar si dhe të Anullohet kontrata mbi faljen.

Nga të lartëcekurat u vërtetua së punët juridike nule, nuk prodhojn efekte juridike që nga fillimi dhe janë nule sipas fuqisë ligjore, e në rastin konkret kemi të bëjm me punë juridike fiktive-nule. Në të gjitha rastet kur kemi të bëjm me punë juridike të pavlefshme atëherë nuk kemi më as bazën për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo.

Sa i perket pikes **II** te dispozitivit te aktgjykimit, gjykata hudhi posht kerkespadin e te paditurit-kundrpaditesit si te parregullt nga se e njejta ne kunderpadin e tije nuk kishte prfshir si te paditur edhe shitesen e kesaj palujtshmerie tani lendore

Gjykat zhvilloi edhe prova te tjera por nuk iu beri ndonje analiz te veqant nga se ishin irelevante per vendosje ndryshe ne ket qeshtje tani lendore.

Mbi bazën e vërtetuar te gjendjes faktike si me lart gjykata, vendosi si ne dispozitiv te ketije akgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nen. 450 te LPK, duke i njohur shpenzimet e Perfaqsesit te perkohshem



dhe ate per pjesmarrje ne 4- seanca shumen prej gjithsejt 422,00 Euro., konform nen 7 te TA.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.174/2018 Datë: 13.05.2019.**

**GJYQTARI**  
Ragip Kadriu

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës brenda afatit 15 ditor, që nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.